



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.567/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë; me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Naim Raçit, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruara nga Naim Raçit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjë ZL.Anr.567/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it me datën 09.11.2017, në ora 12:00, ka pranuar një ankesë nga Naim Raçi, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën thekson se në këtë Qendër të Votimit 1829E, jamë i bindur se votat e mija janë vjedhur nga komisionarët. Më tutje ka shtuar se në Vendvotimet me numër 1812/01R, 1812/02R, 1812/03R kamë vota familjare dhe për këtë jamë i gatshëm të dëshmoj në gjykatë. Po ashtu ka shtuar se, në vendvotimin nr. 1820E/01R, kanë votuar për mua familjet e Fatmire Sylejmanit, Fadil Rrahmanit dhe Enver Bahtirit . Për më tepër ka theksuar se në vendvotimin 1841E/01R kamë informacione se mu janë vjedhur 8 vota dhe këto të cekura i dëshmojnë vëzhguesit Veton Zeneli i njëjti ka qenë i rregullt në këtë vendvotim, duke shtuar se në këto vendvotime 1802X/01R, 1802X/02R, 1802X/03R kanë votuar familja ime prej 25 anëtarë dhe i kamë vetëm gjysmën e votave për këto pretendime jamë i gatshëm të dëshmoj edhe në gjykatë .

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

- Paneli i PZAP-it, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta për të vërtetuar pretendimet në ankesë, të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes së ankesës gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj.

Paneli konstaton se ankesa e ankuesit nuk i plotëson këto standarde ligjore. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse dhe nuk e ka specifikuar qartë se sa vota i mungojnë në secilën Qendër të Votimit për të vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me keqpërdorimin e votave në ditën e votimit. Më tej në qendrat e votimeve të lartë cekura, ashtu si është përcaktuar në nenin 5.7 pika (b) dhe (c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-së nr.02/2015, ku përcaktohet: *“Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku këto informacione: një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar; hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit”*.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të dispozitave të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli i PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.567/2017 më datën 10.11.2017



Kryesuesi i Panelit
Cytenë Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.